



AKADEMIA E SIGURISE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 98 Prot.

Tiranë më 09.09. 2022

**VENDIM Nr. 71**

Senati i Akademisë së Sigurisë i mbledhur sot më datën 09.09. 2022 mbasi dëgjoi propozimet e bëra nga dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit dhe Drejtori i Kolegjit Profesional të Formimit Policor, në lidhje me Personelin Akademik të ftuar dhe me kohë të pjesëshme në përputhje me kërkesat e LAL-së dhe të Statutit të AS-së neni 42, 43, 44.

**VENDOSI:**

1. Miratimin e përbërjes së personelit akademik të paraqitur nga dekani i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit dhe Drejtori i Kolegjit Profesional të Formimit Policor. Bashkëngjitur këtij vendimi, lista e personelit akademik.
2. Personeli akademik i brendshëm të rifreskojë dosjet personale në përputhje me standartet që kërkohen për personelin akademik.
3. Për personelin akademik me kohë të pjesëshme, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit dhe Kolegji Profesional i Formimit Policor, të paraqesë tek Sektori i Burimeve Njerëzore AS-së, dokumentacionin e domosdoshëm dhe më pas Sektori i Burimeve Njerëzore të hartojë dhe miratojë tek Drejtori/Rektori i AS-së, kontratat individuale për personelin akademik me kohë të pjesëshme.
4. Në përfundim të çdo simestri (sezoni) Departamentet me miratimin e Dekanit të Fakultetit dhe Drejtorit të Kolegjit, të hartojnë ngarkesën mësimore të realizuar nga personeli akademik me kohë të pjesëshme sipas standartit përkatës dhe ta dërgojnë atë tek Sektori i Burimeve Njerëzore i AS-së, për veprime të mëtejshme.

**Kryetari i Senatit**

**Prof. Dr. Ilirjan MANDROKA**

Tiranë më 09.09. 2022

